



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 25 maj 2011, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Ekrem Hoxha dhe Fatmir Gërvalla - ART.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore - KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2010,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2010

Kryesuesi - Pasqyrat që janë prezantuar, prezantohen si pasqyra të parregullta me thekës të veçantë, mënyra dhe problemet që shtjellohen më poshtë i ngjasojnë se është një raport i kualifikuar. Nga 12 rekomandimet e vitit të kaluar 4 janë trajtuar, të tjerat janë në proces, mirëpo nuk tregojnë në çfarë faze dhe 8 në proces për lexuesin kërkohet sqarim. ART- nuk kishte në

program ndonjë plan veprimi me adresimin e rekomandimeve të auditimit të vitit të kaluar, pastaj buxheti i ART-së shihet që është shkurtuar disa herë, e tëra shumë e zbritur është dedikuar për investime kapitale. Motiv për këtë ishte kursimi i mjeteve buxhetore sipas kërkesës së vet ART-së, drejtuesve të Ministrisë së Financave, për shkak të mos realizimit të projektit “*Qendra Nazionale e Monitorimit të Radios*”. Kërkoj një sqarim për këtë. Buxheti është përdorë në aspektin kohor jo në mënyrë proporcionale, vetëm në dhjetor e kemi 43%. Gjatë 11 muajve buxheti është harxhuar 57%, kurse në muajin dhjetor është harxhuar 43%. Vlera e pasurisë e prezantuar në pasqyrat financiare nuk është e plotë në këtë vlerë nuk është përfshirë e tërë pasuria me të cilën disponon ART. Ka ndryshim në mesë mënyrës së regjistrimit. Gjatë vitit 2010 të hyrat e mbledhura ishin në shumë prej 9.558.542 euro nga kjo shumë 5.913.203 euro janë të hyra të viteve të mëhershme. Pse kjo? Çfarë kamate llogaritet dhe çfarë masa ndëshkuese kemi ndërmarrë ndaj këtij rasti. Po ashtu mjetet të pagesave në këste kërkon një sqarim, sepse pagesat nuk janë bërë brenda afatit prej 15 ditësh që është e paraparë dhe shuma nuk është e vogël. Për këto licenca të lëshuara ART-ja kishte mundësuar pagesën e tarifës, duke favorizuar ofertuesit e këtyre shërbimeve në vlerën e përbashkët 1.238.630 euro.

Është lëshuar licencë pa kërkesë për licencë. Me datën 13.02.2009 ish kryetar i bordit ka nxjerr një rregullore që auditori e konstaton që nuk është në rregull ajo dhe ju kemi vepruar njëjtë.

Anashkalimi i procedurave në pajtim me “zero” për destinacionin e stacioneve bazë të operatorëve ilegal. ART nuk ka ndjekë procedurat e prokurimit të kërkuar sipas LPP-së. Zgjedhja e operatorit të fituar është bërë nga bordi, bordi kishte vendosur ta përzgjedh kompaninë jo më të lirë me kusht që të zvogëloj çmimin e ofertuar në nivelin e ofertuesve më të lirë, ky është favorizim i një operatori ekonomik që bie ndeshë me LPP-në. Mosrespektimi i procedurave të rekrutimit mënyra se si është rekrutuar një sekretarësh.

Dobësitë e identifikuara në menaxhimin e pasurisë, automjeti i tipit “Mercedes” për radio monitorim në regjistrat e thesarit është i regjistruar në shumën prej 502.823 euro, ndërsa në regjistrat e ART-së është i regjistruar në shumën prej 443.391 euro. Pra, është një ndryshim prej 136.658 euro.

Te prokurimi kontrolla menaxheriale, të dy vendimet ishin shqyrtuar edhe anuluar nga institucionet e pavarura kompetente njëri nga OSHP dhe tjetri nga KPM, për këtë kemi paguar gjorbë. Hap Diskutimin.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm- Theksimi i çështjes në këtë rast ka të bëjë me faktin që pasurit nuk janë shpalosur ashtu si duhet. Problemet për sa i përket kësaj lloji shpalosje nuk kanë ndonjë ndikim tek pasqyrat vendore financiare dhe pastaj vijmë tek menaxhimi financiar në këtë institucion, dhe këtu kemi të bëjë me disa çështje të cilat drejtori dhe bordi i këtij institucioni duhet t'i trajtojnë në një mënyrë më të mirë.

Mujë Gashi ZAP- ZAP, gjatë vitit aktual ka kryer një aktivitet preliminar apo parapërgatitor për procesin e auditimit në bazë të një pyetësoi që ka dorëzuar te ART-ja. Opinion është “*i pakualifikuar me theksim të çështjes*” që do të thotë se pasqyrat prezantojnë një pamje të drejtë dhe reale. Me qëllim të përmirësimit të funksionit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, i është rekomanduar menaxhmentit të ART-së, që të siguroj buxhetin realistik të shpenzimeve të bazuar në vlerësimin e nevojave që do të ndikojë në shfrytëzimin efikas të buxhetit, ndërmarrjen e masave për regjistrimin kontabël të të gjitha pasurive si dhe raportimin e tyre të plotë e të saktë të pasqyrave vjetore financiare. Aplikimin e ndëshkimeve ligjore në situatat ku tarifat e caktuara nuk paguhen me kohë, rishikimin e rregullores së re për licenca për të vlerësuar vlefshmërinë dhe ndikimin e saj, delegimin e mirëfilltë të të hyrave dhe përgjegjësisë nga menaxhmenti në mënyrë që të evitohet konflikti i mundshëm i interesit, vendosjen e mekanizmave të mirëfilltë të kontrollit të brendshëm në mënyrë që të siguroj kryerjen e funksioneve në përputhshmëri me objektivat e përcaktuara nga ART.

Ekrem Hoxha – ART- Për ART-në të gjetura dhe rekomandimet janë udhërrëfyes për të tejkaluar lëshimet eventuale që janë gjete. ART-ja në mënyrë substanciale ka mendim të kundërt me ZAP-in dhe këto mendime janë paraqitur në komente gjatë shqyrtimeve që janë bërë me ZAP-in. Nuk mund të prejdukohet se mund të ketë konflikt interesi - te rasti i personelit ku nuk

ka marrë asnjë provë apo nuk ka provuar asnjë metodologji për vlerësimin se si e ka verifikuar ngarkesën kundër mos ngarkesës. Sa i përket aplikimit të ndëshkimeve që parashihet në nenin 9.3 të Ligjit të telekomunikacionit, ftoj çdo legalist në Kosovë edhe ZAP-in që të gjeje një interpretim të unifikuar të ligjit dhe rregullores në fuqi që në mënyrë eksplicite e parasheh aplikimin e masave ndëshkuese. Frekuenca është valë elektromagnetike e cila lirohet dhe qarkullon dhe asnjë rregullator në botë nuk ka mekanizëm të kontrollit me ndal valën elektromagnetike dhe me ju ndalu përdorimin një përdoruesi. Neni 4.5 e rregullores thotë, “*nëse nuk kryhet pagesa mbas 15 ditë nuk nënkupton se aplikuesi ka hekur drejt nga aplikimi*”, pra këtu nuk kemi bazë për shpallje ndëshkimi dhe ART tek atëherë shkon dhe bënë verifikimin se a e ka përdorë x personi apo x entiteti atë valë elektromagnetike dhe vetëm nëse konstatohet përdorimi krijohet baza legale për shqiptim të ndëshkimit. ART pajtohet se kontrolli i brendshëm në vazhdimësi duhet të avancohet në çdo institucion. 3 fatura që thotë vonesë e paguar ZAP-i nuk i ka provuar se cilat janë ato, apo licenca që thotë janë dhënë pa aplikim nuk qëndron ajo. Nuk jepet një licencë pa aplikim. Vala i përdor në vazhdimësi për dhjetë vite për sa vite është në operim të njëjtat valë dhe varësisht prej teknologjisë që e futë në përdorim ajo mund të njoftoj ART- në se mundë të hejë dorë nga kanali 25 dhe e dëshiron kanalin 50 se i lejon fuqi më të madhe transemtuese dhe mjafton një njoftim elektronik me ART-në dhe ajo ndërmerre veprimet monitoruese dhe a qëndron ajo në praktikë. ART-ja zotohet se veçse e ka përgatitur planin aksional për adresimin e këtyre të gjeturave gjatë vitit 2011 dhe atë në koordinim dhe në mbështetje nga ZAP-i.

Rekomandimet nga viti i kaluar - raporti i auditimit i vitit 2009 është publik në web faqen e ART-së. Nga 8 veprimet e propozuara, 6 janë realizuar dhe 2 kanë qenë në vijim e sipër dhe ka cikle të cilat nuk mbyllen brenda një viti kalendarik.

Çështja tjetër plan veprimi i auditimit të vitit të kaluar. Me një kërkesë të thjeshtë kolegjiale apo profesionale a mund të na jepni një mostër si të bëhet një plan i veprimit, auditori nuk na i kanë dhënë. Natyrisht se ne nuk e kemi atë përvojën se si të bëjmë excel tabelë, por në procedura është e pranueshme për të gjitha ato, që nga auditimi 2009 ne kemi dhënë instruksione përgjegjësve se si të adresohen dhe në procedura interne te ne ajo është lexuar si plan i veprimit.

Kthimi i mjeteve - është e vërtetë që ART-ja ka pas një jo-efikasitet në implementim të buxhetit, por po ky i njëjti jo-efikasitet nuk ka rrjedhë si rezultat i performancës të menaxhmentit apo personelit të ART-së. Mos realizimi i këtij projekti nuk është varur nga ART-ja, por nga procedura që sot janë në Gjykatën Supreme. Nuk mund të quhet joefikasitet kur ART-ja konstaton se nuk mund të realizohet projekti shkaku i faktorëve ekstrem që nuk janë në kontrollin e ART-së.

Akumulimi i shpenzimeve ne pjesën e fundit në nivel të 435 si është reflektuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, është një sindrom që i përcjell shumicën e institucioneve. Në vitin 2010 kemi pasur vështirësi të caktuara me personelin sidomos në zyrën e prokurimit dhe kjo drejtpërdrejt ka ndikuar në atë. Te regjistrimi i pasurisë – kjo është tejkaluar. Ky nuk ka qenë lëshim i zyrtarit të ART-së, por ka qenë sistemi i thesarit i cili për një periudhë kohore nuk ka qenë funksional.

Menaxhmet i ri ka gjet një ART e cila nuk ka inkasuar mjete fare, nuk i ka përmbushë detyrat ligjore në inkasim të detyrimeve të tarifave për shfrytëzim të resurseve frekuencore dhe enumeracionit. Bordi paraparak nuk ka paraqit asnjëherë kërkesën ndaj debitorëve për shlyerje detyrimi dhe ART-ja kur e ka marrë gjendjen ka konstatuar se “x” operator kanë përdorë resurset e fundme që janë resurse të këtij shteti dhe është dashtë më dokumentuar përmes raporteve se kush çka ka përdorë, cilat vendime kanë qenë të sjella cilat duhet të sjellën për të krijuar bazën ligjore me i inkasu 5 milionë e 900 mijë dhe natyrisht kur një institucion publik shkon dhe i thotë një debitori se ju më detyroheni 6 milionë euro kur ata nuk e kanë pas të planifikuar në rrjedhën e parasë së tyre detyrimisht del një çrregullim i rrjedhës së parasë dhe për ART- në ligj kur nuk ka mënyrë eksplicite ku thotë detyrimet e akumuluar rrjedh interesi apo gjëra tjera ne nuk kemi të drejtën e sjelljes së akteve të ligjit ne kemi të drejtën e sjelljeve të akteve sekondare dhe ato akte sekondare janë të bazuara ne ligj pra ne kemi korrigjuar një defekt shumë të madh nga bordi paraparak duke interpretuar me saktësi absolute ligjin e telekomunikacionit dhe rregulloret e ART.

Ne nuk jemi për të çrregulluar një gjendje e cila është krijuar, por jemi për me rregulluar dhe me i kriju hapësirë për investime të reja investorëve. Te rasti i PTK-së, te tri faturat, ndarja me këste është rasti i operatorit publik - për pesë vite PTK-ja ka pas interferime shfrytëzim të paautorizuar nga operatorët tjerë ilegal të spektrit që e ka përdorë dhe kur e ka pastruar atë tabelë të kanaleve në përdorim ART-ja, janë krijuar parakushte për të dërguar fatura. Si operator publik ata janë rendit edhe një ligji për ndërmarrjet publike dhe ata i kanë ciklin e vetë të pagesave. Nuk ndodhë detyrimi nga aspekti legal pason vërejtja nuk pason me automatizëm ndëshkimi. Nëse e shikojmë versionin e parë të raportit auditori thotë ART-ja e ka dëmtuar buxhetin prej 3.900.000, është dashtë ne me i dhënë një mori dokumentacionesh me provë që e kanë verifikim të gabuar dhe ka rezultuar me këto tri fatura se ka vonesë treditore dhe tri dite apo katër ditë prej tyre kanë qenë festë e fundvitit. A mund të shqiptohet dënimi në diçka e cila është korrigjim i një detyrimi ligjor të krijuar pesë vite paraprake. Ndarja në këste - Bordi i ART-së si strukturë menaxheriale e zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka kompetencën ligjore për me nxjerrë ligje sekondare dhe vendimet e ART-së janë vendime të krahasueshme me vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Pra, mund të apelohe vetëm në gjykatën e shkallës së dytë.

Dhënia e licencës pa aplikim - licenca lëshohet kur përmbushen të gjitha parakushtet pra njëri prej parakushteve është dokumentimi që është kryer pagesa dhe me sigurinë absolute ju konfirmoj se asnjë licencë me përjashtim të njërit se ka pas mospërputhje në data që është lëshim teknik nuk ka lëshim diskriminues apo favorizues, nuk ka asnjë lëshim të qëllimshëm apo në shkelje të ligjit, por ka lëshim teknik në njërën licencë. Por aplikimi dallon nga operatorët tek qytetarët apo tek individët. Rasti i operatorëve që kanë një kontinuitet për përdorim të njëjtë të kanaleve mjafton një verifikim. Nuk qëndron e gjetura se lëshimi i licencave është bërë në mospajtim me rregulloren. Rregullorja është e vërtetë që është nxjerrë nga bordi paraprak pa mandate ligjor, por brenda afatit të konsultimeve ART ka dërguar provën se është validu ajo Rregullore dhe efekti financiar nga ajo ka qenë i njëjtë. Te rregullorja me mandatë të skaduar, kjo është nënshkruar nga ish kryetari pas skadimit të mandatit në muajin nëntor prova 255/2.

Blerjet dhe pagesat - operatorët ilegal - deinstalimi i infrastrukturës së operatorëve serbë, mjetet janë nda për këtë projekt nga qeveria me vendim. Projekti është zbatuar në koordinim me MF gjegjësisht ATK dhe MPB, Policinë e Kosovës. Projekti "O" ka qenë sekret shtetëror dhe vetëm katër zyrtarë të nivelit shtetëror kanë pas informacione kur do të ndodhë, cilat lokacione do të ndodhin. Me shkresën e datës 25.02 në tri faqe është njoftuar Qeveria e Kosovës se ART-ja nuk mund të zbatoj këtë projekt në përputhje me LPP dhe në mënyrë indirekte ka kërkuar nga kryeministri i vendit që të aplikohet neni 3.1 i këtij ligji pika 1 " ekzekutimi i kontratës në fjalë sipas ligjit të aplikueshëm kërkon përdorimin e masave të veçanta të sigurisë".

Lidhur me procedurat e rekrutimit - të sqarohet nga auditori se cili nen nuk është respektuar në procedurën e rekrutimit. Kontrolli i brendshëm - pse nuk është komentuar ndonjë udhëzim administrativ i ndonjë institucioni ku thotë ka konflikt potencial interesi.

Çështja e OSHP-së - kjo është çështje e vitit 2010 e jo 2011, por është inicuar në vitin 2010 por nuk ka pasur angazhim të fondeve publike për të qenë subjekt i monitorimit të auditorit gjeneral dhe për më shumë gjatë prezencës së tyre në ART kanë pas akses të vazhdueshëm në arkiv ku e kanë pa kopjen a padisë që është bërë nga ART-ja në Gjykatën Supreme. ZAP thotë se nuk na është ofruar asnjë dëshmi - ajo dëshmi ju është dorëzuar me datën 27.

ART nuk është dënuar me 30.000euro nga OSHP. OSHP ka shqiptuar një dënim ndaj ART –së cili është kontestu në procedurë administrative pranë Gjykatës Supreme e cila sjell vendim meritor në favor të ART-së.

ART zotohet për bashkëpunimin e ngushtë me ZAP-in, kontrolli i brendshëm do të avancohet në vazhdimësi.

Kryesuesi - ZAP këtë vit për herë të parë ka bërë auditimin e ART-së. Në vitet e shkuara ART ka angazhuar kompani private dhe ata kanë bërë auditimin, ndërkohë në raportin e vitit të kaluar që i referohet ZAP nuk ka rekomandime, kërkoj sqarim lidhur me këtë nga auditori.

Mujë Gashi – ZAP - Auditimin e mëhershëm të pasqyrave financiare e kanë bërë kompanitë private të angazhuara nga vetë ART-ja. Rekomandimet janë në letër e cila i dërgohet menaxhmentit për çështjet e ngritura dhe kërkohet se si menaxhmentit do ti adreson ato. Sa i

përket çështjeve që ZAP ka ngritur është çështja rreth regjistrimit të aseteve. Është e vërtetë që asetet janë ble në vitin 2010, por nuk janë regjistruar në vitin 2010 dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat e vitit 2010. Ato janë regjistruar në vitin 2010 për atë ne e kemi cekur këtë çështje është edhe shuma e saktë sa ka qenë ajo rreth vonesave për pagesa për operatorët, ligji në mënyrë decitive e shpjegon se në rast të vonesave çka kërkohet nga ART të ndërmarrë. Të gjitha çështjet që janë pjesë e raportit janë të mbështetura me dokumente dëshmi. ZAP ka pas të qartë se kur është bërë faturimi nga ana e ART-së dhe kur është bërë pagesa, faturimi është bërë në fund të vitit 2009, ndërsa është inkasuar në fund të muajit të parë të vitit 2010.

Sa i përket projektit “O” është shumë e vërtetë që këta ART ka bërë kërkesë Ministrisë gjegjësisht Qeverisë për alokimin e mjeteve, dhe Qeveria e ka lejuar, mirëpo nuk do të thotë që qeveria e ka lejuar të zhvillohet pa respektimin e procedurave të prokurimit. ART është dashur të kërkojë nga Agjencioni i Prokurimit Publik që për shkak të specifikave që i ka projekti të liron të mos zhvilloj procedurat e prokurimit. Çështja rreth vendimit të OSHP dhe vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës - këto janë institucione të pavarura të cilat i ka themeluar vetë Kuvendi. dhe mos respektimi i vendimeve të ndërsjella për ne ka qenë një çështje shqetësuese, për atë ZAP ka thënë se i ka pru dy vendime një OSHP rreth prokurimeve dhe tjetra Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës rreth rekrutimeve, por asnjëra nuk është realizuar nga ART. Ne kemi ngritur këto çështje që Kuvendi të diskutoj këto çështje sa i përket vendimeve dhe shqyrtimeve për shkak veprimeve reciproke.

Muhamet Mustafa – Kërkoi sqarim se ku është ai konflikt interesi, ku ekziston ky rrezik potencial për konflikt interesi se ky është problem shumë i ndjeshëm dhe thelbësor për komisionin?

Mujë Gashi – ZAP- Disa procese që janë shumë të ndjeshme, pavarësisht angazhimit është mirë që të ndahen përgjegjësit. Zyrtari ligjor ushtron edhe pozitën e shefit të personelit, ndërsa udhëheqësi financiar është marrë edhe më çështjet e të hyrave. Ndoshta në aspektin rregullativ nuk është bërë darja e përgjegjësi për shkak se vetë përpilon buxhetin vet regjistron transaksionet, vet bën faturimin vet bën regjistrimin, vet bën raportimin është një çështje.

Ramiz Lladrovci – U interesua për projektin “O”. Kontrata me shtesë ka qenë 60.3500 euro. Pyeti: sa ka qenë kontrata pa shtesë edhe sa stacione janë deinstaluar.

Mursel Haljilji – Pyeti: çfarë ka qenë numri i rekomandimeve 12 apo 8 dhe cilat janë ato? Cilat prej këtyre 8 rekomandimeve janë adresuar. Pra, duhet filluar nga faqja e parë e jo nga faqja e shtatë, sepse këtu qëndron problemi. Këtu kemi të bëjmë me kompani private të revizionit, mirëpo të nisemi nga kjo - nëse janë 8 apo 12 rekomandime dhe a janë adresuar?

Afrim Hoti – Në tremujorin e fundit buxheti është shpenzuar 43%. A është arsyetim i ART- së që të mos zvogëlohet, apo pse ndodh kjo?

Valbona Dibra –Propozoi që shqyrtimi i raporteve në Komision të bëhet para se ato të publikohen. Pyeti: pse paraprakisht ART nuk ka kontaktuar ZAP-in, duke pasur parasysh faktin se ART merr një letër paraprakisht nga ZAP-i, ku edhe shihet objektiva e auditimit. Të gjeturat e auditorit janë ekzistence, pavarësisht asyeshmërisë që çkyçja e operatorëve ilegal është problem që preokupon të gjithë, megjithatë procedurat ligjore në këtë rast nuk janë zbatuar dhe e gjetura ekziston.

Armend Zemaj – Tha se duhet të shqyrtohet çështja publikimit të raporteve, pasi që ato të shqyrtohen në këtë komision. Kjo jo për të ndërhyrë në kompetencat e këtyre organeve, por të jepet një opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes duke marrë parasysh nga raporti i shqyrtuar në këtë komision me të njëjtin opinion, të gjeturat janë diametralisht të kundërta me ato që janë paraqitur në këtë raport. Besoj në pavarësinë e këtyre dy institucioneve, mirëpo pavarësia e këtyre institucioneve përfundon në Kuvend. Komisionit i intereson menaxhimi i parasë publike dhe i taksa-paguesve të këtij vendi. Ligjet nuk janë të përkryera në Kosovë, sidomos Ligji për

Prokurim, dhe në raste të caktuara p.sh rastet sekrete kjo është e mirëseardhur dhe ka ndodhur në atë kohë kur tendenca e dëmtimit të buxhetit ka qenë shumë më e madhe në atë kohë se sa 63 mijë apo 37 mijë euro. Sqarimet për çështjet e caktuara duhet të jenë më të elaboruara, sepse jo të gjithë e kuptojnë konfliktin e interesit. Këto sqarime nuk e ngarkojnë raportin. ART është dënuar nga OSHP – çka është dënuar, nga mungesa e të dhënave në raport ne si deputet duhet të presim raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, për të parë se cilat procedura nuk i ka përfillur ART.

Mujë Gashi – ZAP – Për 4 rekomandime nga viti i kaluar, ZAP ka thënë se janë në proces të implementimit. Ato janë: shtimi i masave në kontrollin e brendshëm në fushat e vlerësuara, marrja e hapave të mëtejshëm në përmirësimin e kontrollin e procedurave të prokurimit në bazë të ligjit, aplikimin e gjobave në pajtim me UA 2004/03 me tarifë 25% të taksës së kërkuar për mos pagesa apo pagesa të vonuara dhe regjistrimi i pasurisë në pajtim me Udhëzimin.

Murselj Haljilji – ZAP është dashur të thotë se në këto 4 rekomandime ka nën-rekomandime, sepse në mënyrën si është paraqitur në raport ka paqartësi. Në raport prezantohen 12 rekomandime, ndërsa tani sipas përfaqësuesve të ZAP-it del se është fjala për 4 rekomandime. Kjo duhet sqaruar në raport.

Ekrem Hoxha - ART- Nuk ka pas saktësi në gjetjet e ZAP-it. Sipas Ligjit ART emëron një auditorë të kualifikuar që të bëjë revizionimin e llogarive në pajtim me ligjet e Kosovës. Nga takimi me auditorin e përgjithshëm, ART-ja ka hequr dorë nga një auditim i tillë me qëllim të mos shpenzimit të parasë publike, sepse ka pasur pritje se ZAP do të bëjë një auditim të rregullsisë. Auditori i vitit 2009 ka konstatuar 6 të gjetura të cilat nuk kanë qenë të gjetura me kualifikim, por të gjetura me rekomandim për përmirësim si p.sh shtimi i masave të kontrollit – kjo vazhdon çdo vit, marrja e hapave të mëtejshëm mbi përmirësimin e kontrollit mbi implementimin e procedurave të prokurimit ART ka marrë masa, ish zyrtarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, është dërguar në hetuesi, për procedim. Aplikimin e gjobave – kjo është aplikuar. Menaxhimi i pasurisë - kjo është çështja e theksuar- zyrtarja e pasurisë e ka marrë udhëzimin e pasurisë se si të adresohet saktë kjo e gjetur, kjo nuk është relevante për menaxhimin e parasë.

Muhamet Mustafa – Çështje shumë relevante është mënyra e evidencimit të pasurisë. Në secilin raport të auditimit pasuria fikse, nuk është si duhet në kontabilitetin e organizatave. Lidhur me këtë Komisioni ndoshta duhet të raportojë në Kuvend dhe pastaj edhe në Qeveri.

Ekrem Hoxha – ART – Është relevante, dhe ART çdo vit e ka evidentuar pasurinë, por kjo e dhënë nuk ka qenë e futur në thesar. Sa i përket konfliktit të interesit – nuk ka Udhëzim Administrativ që i ndalon që zyrtari financiar se nuk mund të jetë zyrtarë i të hyrave. Departamentet i dorëzojnë përlllogaritjet te zyrtari financiar i cili e merr dhe sistemi është ai i cili e shtyp faturën. Çfarë angazhimi ngarkese ka aty? Buxheti aktual dhe Kuvendi nuk lejon që ART të ketë zyrtar të të hyrave. Zyrtari ligjor është zyrtar ligjor administrativ – këtu nuk ka konflikt interesit. Projekti “O” nuk ka anashkalim të procedurave – një autoritet i pavarur krejt çka ka mundur të bëjë është se ka paraqitur kërkesën dhe ka njoftuar se ky projekt pas konsultimeve intensive me MF-në dhe me MPB –në nuk mund të ekzekutohet me transparencë të shtuar për arsye se asnjë operator ekonomik nuk do të bënte deinstalimin po të ishte demaskuar nga pala. Ky projekt është realizuar me procedura “ad hoc” me miratim të Qeverisë dhe me miratim të Bordit.

Ramiz Lladrovci – Para komisionit nuk ka informata të fshehta. Ky Komision është për mbikëqyrje të shpenzimeve të parasë publike dhe gjatë shqyrtimit të informatave mund t'i kualifikoj si sekrete, por Komisioni duhet t'i ketë këto informata. Sipas raportit operatori fitues është operatori i cili e ka ofruar çmimin më të lartë dhe ART e ka marrë me kusht që ky operator të bie në çmimin e atij që është më i ulët. Pse? Pse nuk i është dhënë operatorit më të lirë. Problemi është se ART ka favorizuar operatorin më të shtrenjtë.

Ekrem Hoxha – ART – Çdo procesverbal në ART është i hapur dhe deputetët mund të keni qasje. Asnjë operator nuk do të garantojë po të kishte tender. Pse s'ka ndodhë kjo pesë vite para, pikërisht për shkak të këtyre tentativave me zhvilluar procedura. Informacionet e koduara kanë ardhur prej dy operatorëve të licencuar, sepse kur ngrit një infrastrukturë ngritet nga ekspertët dhe vetëm ata ekspert mundën ta deinstalojnë atë. Informacionet e koduara - janë marrë informata se cilat firma kanë kapacitete dhe ju është bërë ftesa nëse kanë gatishmërinë për të kryer me këtë procedurë. Ne i kemi pasur këto informacione. Është marrë pastaj një reference se kostoja e deinstalimit është 30% më e shtrenjtë se kostoja e instalimit. Bordi ka kërkuar dorëzimin e dy ofertave të cilat kanë ardhur dy dosje tenderime dhe në këtë rast operatori më i lirë nuk ka pasur kapacitete të dokumentuara për të ushtruar këtë punë. Bordi ka ofruar nëse kjo punë mundet të kryhet nga kjo kompani me këtë çmim - ajo ka pranuar. Bordi ka vlerësuar dosjet, neni 3.1 LPP. Kuvendi ka kërkuar që të largohen operatorët ilegal dhe si ka mundur të bëhet kjo?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Në rastin konkret bordi e ka shkelur ligjin. Ndarja e detyrave është parim në menaxhimin e financave dhe për këtë në MF ka parime politika dhe udhëzime dhe nëse këto institucione të vogla të pavarura duhet të kenë ndarje të plotë të detyrave në atë mënyrë që përcakton MF. MF është në dijeni për këtë dhe kanë dhënë mundësinë për të bërë një shfrytëzim të përbashkët të auditorëve të brendshëm dhe të Komiteteve të auditimit ku diskutohen disa shërbime të vogla mund ti marrin p.sh prokurimit. Ne duhet të punojmë për të gjetur zgjidhje. ZAP një mënyrë do ta bëjë të gjej mënyra se si të ndërtohet ky vend.

Kryesuesi – Propozoi që së bashku me dy nënkryetarët e komisionit të kenë një takim të ndarë me përfaqësuesit e ART-së dhe me auditorin e përgjithshëm, sepse ka shumë paqartësi që duhet sqaruar. Pastaj të harmonizohen qëndrimet në mes të këtyre dy institucioneve. Të dhënat e auditorit të përgjithshëm janë baza e sistemit. Ligji parasheh të gjitha – prandaj ZAP dhe ART të kenë një takim, të përgatisin raport, pastaj të përgatitet materiali për mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

2. *Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër.*
3. *Detyrohen ART dhe ZAP që në afatin sa më të shkurtër të dorëzojnë dëshmi lidhur me të gjeturat në raportin e ZAP-it për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit, për vitin 2010.*

4. Të ndryshme

- a) mbledhjet e Komisionit

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Mbledhjet e komisionit mbahen në ora 13:30, ndërsa mbledhjet me të ftuarit pastaj vazhdojnë nga ora 14:00.

Mbledhja e komisionit e paraparë për datën 01 qershor 2011, shtyhet për ditën e mërkurë datë 08 Qershor 2011.

- b) Lista e ekspertëve

Kryesuesi njoftoi anëtarët e komisionit se në bazë nenit 4 të Udhëzimit për administrimin e buxhetit të komisioneve parlamentare, Komisionet mund të shqyrtojnë dhe azhurnojnë listën e ekspertëve ekzistues.

Kërkoi nga anëtarët e komisionit që propozimet konkrete t'i bëjnë te njësia për mbështetjen e komisionit, e cila pastaj do ta njoftoj komisionin për listën përfundimtare, për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu